



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 gusht 2011
Nr. ref.: RK129/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 21/10

Parashtruesi

Arta Hyseni

Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A Nr. 1030/2009, të 12 shkurtit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Miraton aktvendimin në vijim:

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është znj. Arta Hyseni, nga Llapashtica e Poshtme, Podujevë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A Nr. 1030/2009, i 12 shkurtit 2010.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe neni 56(2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Parashtruesja e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës më 30 mars 2010. Parashtruesja e kontestoi vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A Nr. 1030/2009, të 12 shkurtit 2010, me të cilin refuzohej ankesa e saj kundër Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP), që rezultoi nga pakënaqësia e saj me dështimin për ta shpallur atë të zgjedhur në Kuvendin Komunal të Podujevës pas zgjedhjeve lokale të mbajtura më 15 nëntor 2009.
5. Në veçanti, parashtruesja pohon që janë shkelur këto dispozita të Kushtetutës: nenet 3 dhe 24 [Barazia para ligjit], dhe neni 45 [Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes].

Përmbledhja e procedurës në Gjykatën Kushtetuese

6. Parashtruesja e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 30 mars 2010. Kryetari i Gjykatës e caktoi Prof. Dr. Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga Enver Hasani (kryesueses) dhe gjyqtarët Kadri Kryeziu dhe Iliriana Islami.

Përmbledhja e fakteve

7. Parashtruesja ishte kandidatë për Kuvendin Komunal të Podujevës në zgjedhjet lokale në Kosovë të mbajtura më 15 nëntor 2009. Parashtruesja pohon që rezultatet paraprake të lëshuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) treguan se ajo fitoi 179 vota, prandaj kishte të drejtë të zgjidhej si anëtare e Kuvendit Komunal për Podujevë. Megjithatë, kur rezultatet përfundimtare u certifikuan nga KQZ-ja, më 14 dhjetor 2009, në to thuhej se ajo kishte fituar 187 vota, kurse një kandidat tjetër kishte pranuar 192 vota. Kjo nënkuptonte që ajo nuk ishte zgjedhur për në Kuvendin Komunal.
8. Ajo thotë se pësoi dëm që rezultoi nga zgjedhjet lokale për shkak të manipulimit të qëllimshëm ose për shkak të llogaritjes së gabuar matematikore të votave. Parashtruesja fillimisht parashtrroi ankesë kundër këtyre rezultateve në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP) më 17 dhjetor 2009.
9. KZAP-i e refuzoi ankesën e saj nëpërmjet vendimit të vet 495/2009, të 22 dhjetorit 2009. Ajo pohon që KZAP-i fare nuk e shqyrtoi gjendjen faktike të votave. KZAP-i tha në atë vendim se pasi Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) i kishte certifikuar rezultatet e zgjedhjeve lokale më 14 dhjetor 2009, rezultatet ishin të detyrueshme. Prandaj, KZAP-i e refuzoi ankesën si të pabazë.
10. Më 29 dhjetor 2009, e pakënaqur me këtë rezultat, parashtruesja pohoi t'i kishte parashtruar një ankesë tjetër KZAP-it. Kësaj radhe, ajo thotë se i dorëzoi të gjitha provat e ankesës dhe përfshiu sqarimin tabelor të numërimit të votave të zgjedhjeve.

11. Përmes vendimit të vet A. Nr. 529/2009, KZAP-i konkludoi se ankesa e parashtrueses kishte të bënte me një çështje të vendosur dhe konkludoi se ankesa e dytë ishte e papranueshme.
12. Parashtruesja ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata Supreme e refuzoi ankesën e saj më 12 shkurt 2010. Gjykata Supreme tha në aktgjykimin e vet se mospërputhja e supozuar e rezultateve përfundimtare me rezultatet paraprake, apo me pritjet e ankueses, nuk ishte arsye për t'u ankuar kundër KQZ-së.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

13. Për të gjykuar për kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregullore të punës.
14. Në Aktvendimin e vet për Papranueshmëri, të nxjerrë në rastin Mimoza Kusari-Lila, në një rast të mëparshëm të znj. Mimoza Kusari, KI- 73/09, të publikuar më 18 mars 2010, Gjykata Kushtetuese përmendi rëndësinë e zgjedhjeve në një shoqëri demokratike. Gjykata Kushtetuese iu referua atij aktvendimi dhe përsëriti vrojtimet e veta në një aktgjykim tjetër të Gjykatës në Rastin Kimete Bikliqi kundër Komisionit Qendror Zgjedhor, Rasti Nr. KI. 09/10, i 14 dhjetorit 2010. Vlen të përmenden disa citate nga vendimi i mëparshëm.

20. Neni 45 i Kushtetutës së Kosovës siguron:

Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

21. Sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokolleve të saj janë drejtpërsëdrejti të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Ato përbejnë pjesën e së Drejtës Kombëtare. Neni 3 i Protokollit të Parë siguron të drejtën për zgjedhje të lira. Siguron se zgjedhje të lira do të mbahen "...me intervale të arsyeshme me votim të fshehtë, në kushte të cilat do të sigurojnë shprehjen e lirë të opinionit të njerëzve ..."

22. Neni 123.2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës siguron se "Vetëqeverisja Lokale ushtrohet nga organe përfaqësuese që zgjidhen me anë të zgjedhjeve të përgjithshme, të lira, të barabarta, direkte dhe të fshehta". Kuvendi i Kosovës ka siguruar një mekanizëm për mbajtjen e Zgjedhjeve të Përgjithshme dhe Lokale duke miratuar Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji Nr. 03/L-073 në Republikën e Kosovës dhe Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 03/L-040.

23. *Natyra e të drejtave për të votuar në zgjedhje dhe për të kandiduar në zgjedhje dallon në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Gjykata ka theksuar se e drejta për të votuar është e drejtë aktive dhe e drejta për t'u zgjedhur është e drejtë pasive. Parashtruesja e kërkesës mban qëndrimin se e drejta e saj për t'u zgjedhur është shkelur. Megjithatë, ka një ndryshim midis të drejtës për t'u zgjedhur dhe të drejtës për të kandiduar në zgjedhje. Jurisprudenca e GJEDNJ tregon se ekziston një liri veprimi e konsiderueshme që shtetet kanë në sistemin e tyre elektoral, dhe ata lejojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi lidhur me mënyrën që janë zhvilluar zgjedhjet dhe se si shpallen rezultatet e zgjedhjeve. Në rastin e Partisë Komuniste të Bashkuar të Turqisë vs Turqia, Gjykata theksoi se "(shtetet) kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi në këtë sferë, por është Gjykata, si mundësia e fundit, e cila vendosë nëse kërkesat e Protokollit të Parë janë pajtuar; ajo kënaqet kur kushtet e vëna nga shtetet nuk zvogëlojnë të drejtat në fjalë dhe deri diku nuk dëmtojnë*

thelbin e tyre ashtu që t'i privojnë këto të drejta nga efektiviteti i tyre; kur atë kërkesa e kushte të vëna nga shtetet imponohen në ndjekje të një qëllimi legjitim; kur mjetet që përdoren nuk janë në disproporcion (shihni Sadek and Others (no.2) vs Turkey, no.25144/94 et ai, 31, ECHR 2002-IV).

24. *GJEDNJ ka shprehur vazhdimisht rëndësinë e zgjedhjeve të lira dhe të demokracisë në aktgjykimet e saj. Në të njëjtin aktgjykim, Gjykata shprehu mendimin e saj për si vijon: "Demokracia paraqitet si modeli i vetëm politik i parashikuar nga Konventa dhe, për pasojë, i vetmi që pajtohet me të". GJEDNJ, në të njëjtin aktgjykim citoi me miratim Kodin e Praktikës së Mirë, i aprovuar nga Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) në seancat e 51 (Udhëzimet) dhe 52 (Raporti) më 5-6 korrik dhe 18-19 tetor 2002 (Opinion nr. 190/2002, CDL-AD(2002) 23 rev). Komisioni Venecias me këtë rast deklaroi:*

Pesë parimet mbi të cilat mbështetet trashëgimia zgjedhore e Evropës janë se zgjedhjet duhet të jenë: universale, të barabarta, të lira, të fshehta dhe përmes një votimi të drejtpërdrejtë. Përveç kësaj, zgjedhjet duhet të mbahen në intervale të rregullta.

25. *Komisioni i Venecias vë në dukje se organizimi i zgjedhjeve duhet të mbikëqyret nga një organ i pavarur, përgjegjës për aplikimin e ligjit zgjedhor dhe që të ketë një sistem efektiv apeli. Sipas ligjit në Kosovë, këto dy funksione kryhen nga KQZ-ja dhe KZAP-i, me të drejtën për ankesë/apel në gjykatë në rastet e parashikuara nga ligji. Vetëm këto dy janë organet të cilat vendosin me të gjitha çështjet lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve, certifikimin e rezultateve dhe kush gjykon mbi ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, siç parashihen me ligj dhe rregullat zgjedhore. Këto janë organe të përhershme e të pavarura.*

26. *Arsyetimi që KQZ dhe KZAP-i kanë këto autorizime dhe të drejta, mbështetet në supozimin se duhet të ketë siguri në procesin e zgjedhjeve. Nevoja e sigurisë në procesin zgjedhor kërkon anulimin e zgjedhjeve vetëm në rastet e shkeljeve më serioze dhe barra e vështirë e të provuarit bie me këdo që pretendon për kesi lloj shkeljesh.*

27. *Roli i Gjykatës Kushtetuese në procesin zgjedhor njihet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku në nenin 106.1 thuhet se KQZ do të certifikojë rezultatet e zgjedhjeve vetëm pasi KZAP dhe Gjykata Kushtetuese të kenë shqyrtuar ankesat e paraqitura. Kjo Gjykatë nuk ka rol tjetër në proceset*

zgjedhore dhe nuk mund të rishqyrtojë, ose rishikojë, vendimet e KQZ-së dhe KZAP-it, përveç rasteve të jashtëzakonshme kur ka ndodhur shkelje e të drejtave dhe lirive individuale të cilat garantohen me Kushtetutë”.

15. Gjatë shqyrtimit të ngjarjeve që shpurën në paraqitjen e kërkesës, Gjykata Kushtetuese vë në pah faktin se parashtruesja kishte një vendim nga KZAP-i në lidhje me pakënaqësinë e saj me rezultatet e zgjedhjeve lokale për komunën e Podujevës. Ajo u përpoq ta ushtronte edhe një ankesë tjetër në KZAP dhe ai vendosi që ankesa e saj tashmë ishte shqyrtuar. Ajo ushtroi ankesë kundër vendimit të dytë të KZAP-it në Gjykatën Supreme, e cila vendosi që ankesa e saj drejtuar tyre nuk ishte e bazuar.
16. Rregulli 36.1 dhe 2 i Rregullores së punës parashikon:

Rregulli 36

Kriteret e pranueshmërisë

1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

a) janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar, ose

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi, ose

c) kërkesa është qartazi e bazuar.

2. Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të së drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

17. Kjo Gjykatë rikujton që nuk mund t'i rishikojë ose kthejë mbrapsht vendimet e KQZ-së apo të KZAP-it nëse nuk ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirive individuale të garantuara me Kushtetutë. Në këtë drejtim, parashtrueses i takon barra e të provuarit për të përcaktuar se shkelja ka ndodhur. Duke pasur këtë parasysh, përsëri, liria e gjerë e vlerësimit që i lejohet Kosovës lidhur me atë se si i mban zgjedhjet e veta, Gjykata Kushtetuese nuk është e kënaqur që parashtruesja në rrethanat e posaçme të kësaj kërkesë nuk e ka mbështetur me prova ankesën e saj dhe prandaj Gjykata duhet ta refuzojë kërkesën si qartazi të pabazë.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113(7) të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

